



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:297244

Datë: 25.05.2024

Numri i dokumentit: 05734816

C.nr.2959/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Shyqri Hoxha, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit A.U. me numër personal me vendbanim në Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.J. nga Prizreni kundër të paditurit KOMPANIA E SIGURIMEVE "EUROSIG" SH.A. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestimit kompesnim dëmi material dhe jo material, me vlerë të kontestit 5000,00 eruo, *jashtë seancës gjyqësore*, me date 24 maj 2024, murr këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia paditësit A.U. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të "**Detyrohet** e paditura Kompania e Sigurimeve " Eurosigg" me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 08.10.2021, paditësit A.U. të ia kompenzoi shumat si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike kërkojmë shumën prej 3000 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1000 euro, në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 4000 euro, në emërt të shëmtimit trupor shumën prej 1000 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën shumën prej 300 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 300 euro, në emër të shpenzimeve materiale për shërim shumën 400 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12%, nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim , në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë, së këtij aktgjykimi nën kërcenimin e përmbarrimit të dhunshëm, si dhe të obligohet e paditura në pagimin e shpenzimeve të procedurës" **NË TËRESI SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi A.U. nga fshati Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.J. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 31.12.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Eurosig" me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material, me vlerë të kontestit prej 5000.00 euro.

I autorizuari i paditësit av. B.J. me parashtrësën e datës 22 05 2024 , e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore , ku janë përmbushur të gjitha kërkesat tona dhe nuk kemi pretendime të tjera financiare ndaj të paditurës lidhur me këtë lëndë, andaj edhe ka paraqitur parashtrësën për heqje dorë nga kërkresëpadia.

Gjykata ne kuptim te dispozitave nga neni 149 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2959/2021, me datë 24 maj 2024

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.